



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:003518
Datë: 28.10.2024
Numri i dokumentit: 06358339

C-IV-14-7032

Ankuesi

M K, Prishtinë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 23 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit, PRN125-0073, të datës 30 tetor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 13 nëntor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN125-0073 datë 30 tetor 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara për periudhën nga viti 1990 – 1999 në shumë prej 38,871.87 € nga N.SH. “Banka Themelore e Kosovës” - Bankkos (*në likuidim*). Ankuesi pohoi se AKP me vendimin e saj e ka refuzuar kërkesën e tij si të pavlefshme dhe se përveç kësaj AL thirret në dispozitat e nenit 608 të LPB (GZ nr. 53/1976). Arsyetimi i vendimit të atakuar është i gabuar sepse aplikimi i dispozitave të Nenit 608 të LPB është i pa justifikuar dhe pa bazuar sepse LPB jo vetëm në territorin e Kosovës, por as në territorin e ish Republikave Jugosllave, tani nuk është i aplikueshëm. Ky ligj ka pushuar së aplikuari në veçanti në territorin e Republikës së Kosovës, pas miratimit të Rezolutës 1244 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Nga ana tjetër në bazë të dispozitave të nenit 87 të Ligjit të Punës nr.03/7-212 të Republikës së Kosovës, të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para,

parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës. Ankuesi më tej theksoi se duke u bazuar në publikimin e shpalljes të AKP-së publikuar në të përditshmen Koha Ditore e datës 03 korrik 2014, për njoftimin e të gjithë kreditorëve që kanë të bëjnë me kërkesat ndaj Bankës Themelore – Bankos SH.A “Banka e Kosovës”, në rastin konkret kreditori konsideron se me kohë dhe në afat është paraqitur me kërkesën e vet për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën kohore prej vitit 1990 – 1999. Përveç asaj që u tha më lartë, kreditori – paditësi nuk ka pasur mundësi e as fuqi ligjore t’i realizoj të drejtat e veta nga baza e marrëdhënies së punës dhe të kërkoj kompensimin e pagave të papaguara për shkak të masave të dhunshme të cilat janë aplikuar në kohën kur janë larguar nga puna. Kjo për arsye se Banka Popullore e Jugosllavisë me aktvendimin për plotësimin e kushteve për hapjen e procedurës të falimentimit ndaj Bankës së Bashkuar të Kosovës me datë 03 tetor 1990, ka propozuar fillimin e hapjes së procedurës së falimentimit. Kështu, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Beograd si gjykatë në procedurë të falimentimit me shifrën ST 207/90 të datës 13 dhjetor 1990 e ka nxjerrë aktvendimin me të cilin ka filluar procedura e falimentimit të Bankës së Bashkuar të Kosovës SH.A. Prishtinë. Nga kjo shihet qartë dhe pa mëdyshje se kreditori – ankuesi për shkak të mos qasjes në aktet normative të Bankës Popullore të Jugosllavisë (data e cituar më lartë), nuk ka patur mundësi ta godasë vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit e me këtë vetvetiu nuk ka patur mundësi as t’i realizojë të drejtat e veta themelore nga marrëdhënia e punës në kuptim të dispozitave të Nenit 608 të LPB në të cilat dispozita tani thirret AKP. Ankuesi i propozon gjykatës që të ndryshohet vendimi i AKP dhe të aprovohet kërkesa dhe të njëjtit ti kompensohet pagat e papaguara për periudhën 1990 – 1999 në shumë prej 38,871.87 € dhe atë prej ditës së ushtrimit të kësaj ankese e deri në ditën e realizimit të tyre, me kamatë bankare sipas normës së kamatës të bankës afariste në territorin e Republikës së Kosovës. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur vetëm vendimin e kundërshtuar.

Me 02 tetor 2024, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontekst, Neni 31 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. E paditura thekson rregullin bazik të procedurës civile kontestimore sipas të cilit pala kërkuese (parashtruesi) ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i LPK-së dhe Neni 31 i Ligjit 06/L-086). Një rregull i tillë është shprehimisht i paraparë edhe në nenin 23.2.4 dhe 23.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. E paditura më tej thekson se ankesa është refuzuar në bazë të nenit 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në, AL e ka shqyrtuar kërkesën dhe e vlerëson si të pavlefshme. Neni i lartcekur parashikon që “...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij Ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë... Kërkesa apo pretendimi është i parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”. Ky nen i jep të drejtën AL të vërtetoj nëse kërkesa është e parashkruar nga ligjet në fuqi të aplikueshme në territorin e Republikës së Kosovës. Më saktësisht neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976) i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, parashikon që “pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo

secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet. Në bazë të dispozitave të mësipërme, një kërkesë monetare e çfarëdo lloji, që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi dhe që e ka burimin nga marrëdhënia kontraktuale midis dy palëve duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur NSH-ja supozohet të mos ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit (pra më së voni tre vjet nga viti 1990). Prandaj, bazuar në më sipër AL refuzon kërkesën si të pavlefshme. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: vendimin e kundërshtuar, Formularin e kërkesës në likuidim dorëzuar tek AKP datë 05 gusht 2014 si dhe Vendimin për Përbërjen / Emërimin e Anëtarëve të AL datë 4 gusht 2023.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në shkresat e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i

VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës, megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuar në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për kompensimin e kërkuar në këtë lëndë sipas vendimit të kundërshtuar të AL nr. PRN125-0073 datë 30 tetor 2014 (për kompensim për paga të papaguara për periudhën nga viti 1990 – 1999 në shumë prej 38,871.87 € nga N.SH. “Banka Themelore e Kosovës” - Bankkos (në likuidim)) ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të papaguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës dhe pohimeve të vet ankuesit, i njëjti kërkesën për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën 1990 – 1999, e ka parashtruar në Autoritetin e Likuidimit më 05 gusht 2014, që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Kërkesa e ankuesit për pagat e pa paguara për periudhën 1990

– 1999, është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar, që i bie se afati i parashkrimit për pagën e fundit ka arritur në qershor 2002, ankuesi kërkesën e ka parashtruar në muajin gusht 2014, që do të thotë jashtë çdo afati të paraparë ligjor. Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore apo se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para qershorit 2002, kështu do të kishim edhe ndërprerje të afatit të parashkrimit.

Gjykata është tërësisht në dijeni për rastet e tilla dhe ka marr parasysh pretendimet e ankuesit për largimin e tij nga puna në mënyrë të kundërligjshme pra pa bazë juridike (si të gjithë punëtorëve të tjerë shqiptarë, të larguar në atë kohë nga aplikimi i masave të dhunshme), por nuk ka mundur të ofroj një zgjidhje tjetër ligjore, sa i përket kompensimit të kërkuar për paga të papaguara për periudhën kohore 1990 – 1999, kjo pasi ka kaluar një kohë jashtëzakonisht e gjatë nga ai moment deri në momentin e paraqitjes së kërkesës së tij në procedurë të likuidimit.

Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit në lidhje me raste të tilla dhe këtë NSH (AC-I-22-0502, AC-I-22-0651, AC-I-21-0462, etj.).

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar